



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES
PËR
PROJEKT RREGULLOREN PËR NJËSIN LIGJORE TË
GJYKATËS KOMERCIAL

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative	<p>Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe funksionimi i Njesisë Ligjore si njësi organizative në kuadër të Gjykatës Komerciale.</p> <p>Më tutje, kjo rregullore zbatohen ndaj të gjithë të punësuarëve në Njësinë Ligjore me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale dhe administrative për Gjykatën Komerciale ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.</p>
2. Arsytimi i aktit normative	<p>Arsyeja e hartimit të projekt Rregullores X/2023 për Njësinë Ligjore të Gjykatës Komerciale është për të treguar funksionet kryesore të Njesis Ligjore, përberjen e saj si dhe funksionet e Këshilltari Ligjor.</p>

	<p>Tutje, me këtë rregullore përcaktohen ndarja e rasteve në njësinë ligjore, detyrat dhe përgjegjësitë e Bashkëpunorit Profesional , detyrat dhe përgjegjësitë e Këshilltarit Profesional, Zyrtarit Ligjor, Zyrtarit të përkthimeve dhe stafit tjetër.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të draft Rregullores për Njësinë Ligjore të Gjykatës Komerciale</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 26 Korrik</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>

